



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2020:022638

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05734174

C.nr. 38/13

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË -DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, me gjyqtarin Shemsedin Haxhijaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit R. (A...) A. nga Istogu, të cilin e përfaqëson A.N avokat nga Peja pranë Shoqërisë së Avokatëve "...” me seli në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve D....., me seli në Prishtinë, rruga “.....” numër 20, të cilën e përfaqëson N.D avokat nga Prishtina, nga baza juridike: kompensim dëmi jomaterial dhe material, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor të datës 25.03.2024, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit R. (A...) A. nga Istogu ashtu që:

**I. DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “D.....”, me seli në Prishtinë, rruga “.....” numër 20, që paditësit R. (A...) A. nga Istogu, në emër të kompensimit të dëmit jo material të shkaktuara në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 03.08.2012, nga baza e auto përgjegjësisë, ti paguaj shumat e specifikuar si më poshtë:

**Në emër të dëmit jo material:**

- për dhimbje të përjetuara fizike.....5,000.00 euro,
- për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.....8,500.00 euro,
- për frikë të përjetuar.....5,000.00 euro,
- për shëmtim.....4,000.00 euro.

**E në shumë të përgjithshme prej .....22,500.00 euro.**

**II. DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “D.....”, me seli në Prishtinë, rruga “.....” numër 20, që paditësit R. (A...) A. nga Istogu, për shumat e gjykuara, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ti paguaj me kamatë ligjore sipas normës, 8%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit me datë 25.03.2024 e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto ti përmbush në afat prej 15 dite, nga dita e parashtrimit të padisë e nën kërcënim të përmbarimit të detyruar

**III. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR**, kërkesë padia e paditësit, R. (A...) A. nga Istogu, përtej shumës së gjykuar, në pikën I, të dispozitivin e këtij aktgjykimi, për aksidentin e datës 03.08.2012 për shumat e specifikuar si më poshtë :

**Në emër të dëmit jo material:**

-dhimbje të përjetuara fizike.....5000 euro,  
-zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.....31,500 euro,  
-frikës së përjetuar.....3000 euro,  
-shëmtim.....6000 euro.

**Në emër të dëmit material:**

- për ndihmë dhe kujdes të huaj.....1,500.00 euro,  
- për ushqim të përforcuar.....1,000.00 euro,  
-shpenzime të mjekimit.....1,000.00 euro,

-Në emër të Rentës së arritur për periudhën kohore prej 03.08.2012 deri më 31.01.2024 shumën prej 104,296.75 euro, si dhe kamatvones;n prej dat;s 03.08.2021 e deri me datë 31.01.2024 shumën prej 21,309.17 euro, apo në shumën e tërësishme prej 125,605.92 euro.

-Në emër rentës vijuese, për të ardhmen duke filluar nga data 01.02.2024 e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, përkatësisht deri me 21.10.2034, kur paditësi do të pensionohet, të njejtit t'i paguhet shuma mujore prej nga 946.62 euro dhe atë në fund të secilit muaj, e më së voni deri me datën pesë të muajit vijues, për secilin muaj paraprak, ose shumën e gjithëmbarshme të rentës për periudhën 01.02.2024 e deri me datë 21.10.2034, prej 98,230.93 euro.

**IV. DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve D....., me seli në Prishtinë që paditësit R. A., të ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumën prej 9,569.00 euro e tërë këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Kjo gjykatë përmes aktvendimit me numër C.nr.38/13 të datës 02.10.2020, ka bërë bashkimin e lëndëve C.nr.28/15 dhe C.nr.38/13, sipas padisë së paditësit R. A., nga Istogu, kundër të paditurës KS "D....." me bazën juridike: kompensim dëmi jomaterial dhe material, pas bashkimit lënda është udhëhequr me shenjën C.nr.38/13.

Paditësi, përmes të autorizuarit së tij me padinë e datës 11.01.2013, parashtrësës për precizim të kërkespadiës të datës 05.03.2024, si dhe gjatë shqyrtimit kryesorë ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tërësi kërkespadinë e paditësit si të bazuar për kompensimin e dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 03.08.2012 nga baza e auto përgjegjësisë.

Në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se gjatë rrjedhës së procedurës e në veçanti me provat përkatëse materiale, dhe atë raportit nga procesverbali policorë, Aktgjykimi penal si dhe

ekspertiza e komunikacionit rrugor me numër P.nr.544/13, në tërësi është vërtetuar baza juridike e kërkespadiisë e që e njëjta nuk është kontestuar as nga e paditura. Në harmoni me ekspertizat mjekësore-superekspertizës së ekspertëve nga degët përkatëse të ortopedisë, neurologjisë, kirurgjisë maksillofaciale dhe të psikiatrisë, me të cilën është konstatuar se paditësi R. A. në aksidentin e datës 03.08.2012 ka pësuar lëndime tejet të rënda trupore, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 30 %, i shprehur me dëmtim të përhershëm, me manifestim të dhimbjeve fizike dhe frikës së të gjitha intensiteteve, si dhe shëmtimit të theksuar trupor, të cilat zgjasin edhe sot e të cilat paditësin do ta përcjellin gjatë gjithë jetës së tij. Bazuar në ekspertizën e mjekësisë së punës është vërtetuar se paditësi R. A. në aksidentin e lartcekur ka pësuar zvogëlim të aktivitetit punues i cili në vitin e parë është shprehur në shkallë prej 100%, në vitin e dytë 60% kurse që nga viti i tretë të njëjtin zvogëlim të aktivitetit punues në shkallë prej 35 % do ta përcjellë gjatë tërë jetës së tij. Me ekspertizën e eksperit financiar aktuarit është vërtetuar lartësia e kësaj kërkespadije, për çka i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta miratojë si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë në mënyrë të specifikuar si vijon: për padi 325 euro, taksën për padi 100 euro, 17 seanca të mbajtura 7.182 euro, 4 seanca të shtyera 844 euro, kompensimin për ekspertët nga lëmia e ortopedisë 400 euro, kompensimin për ekspertin nga lëmia e psikiatrisë 350 euro, kompensimin për ekspertin nga lëmia e kirurgjisë maksillofaciale 150 euro, kompensimin për ekspertin e mjekësisë së punës 250 euro, kompensimin për ekspertin financiar – aktuarin 500 euro, kompensimin për përkthimin e dokumentacionit nga gjuha gjermane 50 euro, në emër të shpenzimeve të mbylljes së zyrës për 17 seanca (7.182x25%) 1.795 euro, shpenzimet e udhëtimit me veturë për 17 seanca të mbajtur dhe 4 të shtyera 21 x 60 km= 1.260 x 30% për km të kaluar 325 euro, e gjithsejtë shumë prej 12,949 euro.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me provat të cilat i kemi në shkresa të lëndës është konfirmuar se paditësi nuk ka mundur të argumentojë kërkesën e tij për sa i përket rentës për shkak të fitimit të munguar dhe shpenzime të shërimit sepse mungojnë transaksionet bankare të paditësit që të na dëshmojë të hyrat financiare që ka pasur paditësi, po ashtu mungojnë edhe kontratat me siguruesin S. si dhe kushtet e këtyre kontratave siguroese, mungojnë edhe provat tjera që ta bëjë të besueshme kërkesën sa i përket formës së dëmit fitim i munguar dhe kjo na dëshmon se për format e dëmit shpenzime të shërimit dhe fitim i munguar i njëjti e ka realizuar kërkesën në shtetin Z. nga siguruesi S.. Për më tepër ekziston edhe deklarata e paditësit se i njëjti është kompensuar për këto kategori dhe çdo vendim tjetër për të aprovuar këtë kërkesë për këto dy kategori do të krijonte pasurim të pa bazë për paditësin. Për këto arsye gjykatës i propozojmë që këto dy forma të dëmit të refuzohen si të pa bazuara dhe ta obligojë paditësin ti paguaj shpenzimet e përfaqësimit. Lidhur me këto dy forma të dëmit si dëshmi gjykatës i kemi dorëzuar aktgjykimin EK.nr.326/15 të datës 16.09.2021, ku është gjykuar për këto dy forma të dëmit të kërkuara nga Siguruesi S., forma të dëmit të cilat siguruesi S. paraprakisht i ka paguar paditësit dhe në formë regresi i ka kërkuar ndaj këtu të paditurës K.S D..... sh.a. Sa i përket formave të tjera të dëmit lidhur me dhimbje fizike, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, frikë të përjetuar dhe shëmtim trupor të njëjtit gjykatës i propozojmë që të gjykojë konform praktikës të deritanishme gjyqësore dhe rregulloreve të cilat janë nxjerr nga BQK për trajtimin e këtyre

kërkesave dhe me ndarje të përgjegjësishë për shkak se është vërtetuar edhe me ekspertizë të komunikacionit se edhe paditësi ka kontribuar në aksident dhe ndarja duhet të jetë së paku 70% me 30% në favor të paditësit. Lidhur me kompensimin për kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar nuk mund ti kërkojë paditësi pasi që i njëjti ka qenë i shtrirë në spital dhe ndihmën e ka pranuar nga stafi shëndetësor. Shpenzimet e kërkuara nga paditësi i propozojmë gjykatës që ti njihen vetëm ato seanca të para deri para se të bëhet bashkimi i lëndës C.nr.38/13 me lëndën C.nr.28/15 në seancën e datës 02.10.2020 dhe jo shpenzimet e krijuara nga kjo seancë e tutje. Njëkohësisht në tërësi kontestohet kamata e kërkuar prej 12% dhe poashtu kontestohet edhe periudha prej kur kërkohet kamata për shkak se paditësit ju kemi përgjigjur me kohë dhe kemi kërkuar që të na dëshmojë bazën juridike për shkak të ndarjes së përgjegjësishë dhe kërkesën e tij ta precizojë për shkak se ka pasur kërkesa të dy anshme si nga paditësi direkt poashtu edhe siguruesi Suva në formë regresi për këtë arsye gjykatës i propozojmë ta refuzojë kërkesën lidhur me kamatën e që të njëjtën ta gjykoj nga dita e aktgjykimi dhe me normë ligjore siç është përcaktuar me ligji.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë nga seanca e datës 02.10.2020, për tri seanca nga 270 euro e gjithsejtë 810 euro.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: ekspertizën financiare të punuar nga eksperti M.M nga Peja të datës 31.01.2024, procesverbalin mbi vendshiqimin e aksidentit me numër DR-.-.-12 të datës 03.08.2012, raportin fillestar policor me numër të rastit dhe datë si më lartë, 9 foto të vendit të ngjarjes ku ka ndodhë aksidenti, aktgjykimin e kësaj gjykate nën shenjë P.nr.544/13 të datës 14.01.2014, të formës së prerë me datë 18.02.2014, janë shikuar 14 fotot e paditësit të pjesëve të trupit në cilat ka pasur lëndime, raportin mjekësorë nga konsultat me numër 17166 të datës 27.10.2014, raportin mjekësor nga konsultat me numër 17166 të datës 27.10.2014, raportin mjekësor të lëshuar nga Spitali Amerikan me numër 3701 të datës 10.06.2014, raportin mjekësor të lëshuar nga Spitali Amerikan në Kosovë të datës 10.08.2014, në gjuhën angleze të përkthyer në gjuhën shqipe, ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti N.A në procedurën penale të datës 07.11.2013, vlerësimin mjekësor të datës 22.06.2015 me numër të dëmit 06.85205.12.2/ege, nga S.... L....të Zvicrës e cila është në gjuhën gjermane dhe e përkthyer në gjuhën shqipe. Ekspertizën mjekësore të përpiluar me shkrim nga ekspertët mjekësorë Dr. A.T, Dr.M.H, Dr.G.SH, kuponin fiskal të lëshuar nga Spitali Special për kirurgji A....1 me seli në Prishtinë-V. në shumë prej 50 euro, ekspertizën e komunikacionit të punuar nga S.B të datës 07.09.2016, ekspertizën mjekësore të punuar nga grupi i mjekëve Dr. XH.S ortoped-traumatolog, Dr. N.H eksperti i kirurgjisë maksillofaciale, Dr. K.Z ekspert i Neurologjisë dhe Dr. N.M ekspertë e psikiatrisë, ekspertizën e ekspertit të mjekësisë së punës Dr. XH.SH të datës 07.01.2023, ekspertizën mjekësore të punuar nga grupi i ekspertëve Dr. V.B ortopedë-traumatologe, Dr. S.R Kirurg maksillofacial, Dr.SH.H Psikiatër, vërtetimin e lëshuar nga QPS në Istog me numër 256 të datës 20.02.2023, certifikatën e lëshuar nga MFPT të datës 20.02.2023 me numër të referencës 576, vërtetimin tatimor të lëshuar nga ATK, të datës 20.02.2023, vërtetimin e punës të lëshuar nga FN B.... G... Bh, V. 11 6062 Vilen të datës 24.04.2023 në gjuhën gjermane dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, pasqyrën bankare për periudhën kohore 01.01.2023-21.09.2023 të datës 16.10.2023 e cila është

në gjuhën gjermane dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, deklaratën e paditësit të datës 16.10.2017, komunikimin përmes emailit të datës 28.08.2023 në mes të G.D nga avokatura I... A.. me të autorizuarin e të paditurës V.R. Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamentit për Çështje Ekonomike, numër 326/15 të datës 16.09.2021, ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti F.S të punuar për departamentit për çështje ekonomike.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike- civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga vërtetimi i lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Istog me numër 256 i datës 20.02.2023, gjykata ka vërtetuar se paditësi R. A. nga Istogu i Poshtëm nuk është shfrytëzues i ndihmës sociale pranë QPS-së.

Nga certifikata e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të datës 20.02.2023 me numër të referencës 576, gjykata ka vërtetuar se paditësi nuk gëzon asnjë pension sipas dispozitave të Rregullores mbi Pensionet e Kosovës (04/L-131).

Nga vërtetimi i punës i lëshuar nga FN B.... G... Bh, V... 11 6062 Vilen e datës 24.04.2023, në gjuhën gjermane e të përkthyer në gjuhën shqipe gjykata ka vërtetuar se paditësi në muajin qershor 2012 ka qenë i punësuar si punëtor profesional Gipser me një pagë mujore bruto 4860 Fr dhe 262 Fr për shpenzime.

Nga deklarata e paditësit e datës 16.10.2017, gjykata ka vërtetuar se paditësi R. A., nga S.. L..., mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm me numër 06.885205.12.2 e përkitazi me pasojat e lëndimeve trupore nga aksidenti i trafikut i datës 03.08.2012 në Kosovë, nga ky sigurues janë bartur dhe paguar mjekimet – shuma prej 149,550.35 CHF në emër të kompensimit për kohën e paaftësisë për punë nga dita e aksidentit e deri më datës 31.11.2016. Shuma e gjithmbarshme prej 327,344.25 CHF.

Nga provat e administruara përkatësisht nga procesverbali mbi vend shikimin e aksidentit me numër DR-3004-1190-12 të datës 03.08.2012, raporti fillestar policor me numër të rastit dhe datë si më lartë, 9 foto të vendit të ngjarjes ku ka ndodhë aksidenti, gjykata ka konstatuar se me datën 03.08.2012 rreth orës 12:00min në afërsi të ETC-së, kishte ndodhur një aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime trupore. Në këtë aksident ishin përfshirë një veturë dhe motoçiklist. Deri te aksidenti ka ardhur nga pakudësia e drejtuesit të veturës.

Me qëllim të përcaktimit të kontributit të pjesëmarrësve në shkaktimin e aksidentit gjykata ka nxjerrë ekspertizën e komunikacionit të punuar nga S.B me datë 07.09.2016 sipas të cilës në aksident ishin të involvuara dy mjete, vetura e markës VolksWagen-Golf 2 me ngasës J. (A...2) H. nga fshati P. Komuna e Istogut dhe mjete i markës Motoçikletë (Yamaha) me ngasës R. (A...) A. nga Istogu, dhe deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur si pasojë e asaj se (J. H.) drejtues i automjetit “A” të tipit Golf i cili ka filluar kthimi majtas-çkyqjen nga rruga kryesore, pa u

plotësuar kushtet e nevojshme, ka pas mundësi me e përceptu lëvizjen e motoçikletës e cila ka qenë duket lëvizur në rrugë nga krahu i kundërt me një shpejtësi të madhe, ky ngasës “A” duke u çkyçur ka kaluar në shiritin (anën) që i takonte për lëvizje motoçikletës – kjo si pasojë e mos respektimit të përparësisë së kalimit gjatë çkyçjes dhe moskujdesit në ngasje. Sipas LSKRR (Ligjit mbi sigurinë e Komunikacionit rrugor) për ngasësin A kemi: Neni 42.1 Shoferi i cili në rrugë synon të bëjë ndonjë veprim me mjetin ( të ndërroj shiritin e komunikacionit, kthimin majtas etj) i lejohe të fillojë një manovrim të tillë, vetëm nëse më parë është i bindur se mund të bëjë një gjë të tillë duke mos rrezikuar apo penguar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion ose pasurinë, duke u kujdesur me këtë rast për pozitën e mjetit dhe për drejtimin e shpejtësisë së lëvizjes. Neni 54.1, Shoferi duhet të ngas mjetin, me shpejtësi adekuate dhe sjellje e cila i lejon shoferit që të kontrollojë mjetin, në kushte ekzistuese të komunikacionit, posaçërisht duke pasur parasysh pamjen, kushtet dhe dukshmërinë e rrugës, kushtet dhe ngarkesën e mjetit, kushtet atmosferike dhe dendësinë e komunikacionit në mënyrë të mjetin e vet ta ndal para çdo pengese. Ngasësi i automjetit Golf duke bërë lëvizje të rrezikshme e ka penguar lëvizjen e motoçikletës e cila ka lëvizur në shiritin e vet të komunikacionit në rrugën me përparësi kalimi, pra e ka mbajtur drejtimin e lëvizjes dhe në këtë mënyrë është shkaktuar aksidenti. Po që se ngasësi i automjetit (Golf) të mos ishte filluar çkyçjen (kthimin majta) pa u plotësuar kushtet e nevojshme, të kishte drejtuar me kujdes më të madhë, ti kishte dhënë përparësin e kalimit motoçikletës dhe të kishte reaguar me kohë, nuk do të kishte ardhur deri te aksidenti. Ndërsa motoçikleta ka lëvizur me shpejtësi jo adekuate mbi 80km/h në zonën e kufizuar me 50 km/h, andaj edhe ky ngasës ka ndikuar në rritjen e vëllimit të dëmeve.

Nga Aktgjykimi me numër P.nr.544/13, i datës 14.01.2014, i formës së prerë me datë 18.02.2014, gjykata ka konstatuar se J. H. nga fshati P. Komuna e Istogut si drejtues i automjetit “VW-Golf 2” me ngjyrë të kaltër me targa të regjistrimit .-.-., është shpallur fajtor për aksidentin e datës 03.08.2012, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297/5 lidhur me nenin 3 të KPK-së.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjene mbështetje në nenin 136, 140, 169, 172, 173 dhe 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i datës 10 maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”.

Me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”.

Me nenin 169 paragraf 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, përcaktohet se: “ 1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t`ia paguajë të dëmtuarit shumën

përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme”.

Me nenin 173 të këtij ligji, përcaktohet se: “ 1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. 2. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër. 3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerr veprimin. 4. Kur sendi është shkatërruar ose dëmtuar me vepër penale të kryer me dashje, gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit sipas vlerave që ka pasur sendi për të dëmtuarin.

Me nenin 183 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, përcaktohet se: “1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton së kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar lidhur me kompensimin e dëmit, me rastin e aksidentit të shkaktuar me fajin e të siguruarit të paditurës të shkaktuar më datë 03.08.2012. Sipas vlerësimit të Gjykatës, kërkesëpadia e paditësit në raport me të paditurin është pjesërisht e bazuar sipas dispozitave ligjore të lartcekura.

Përveç të cekurave në këtë rast baza juridike e kërkesëpadisë gjënë mbështetje në nenin 136 të LMD-së, për arsye se: Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e nenit 136 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t'ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe

dëmit. Në këtë rast janë plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurës, për kompensimin e dëmit, paditësit.

Me qëllim të përcaktimit të llojit, shkallës së pasojave, natyrës së lëndimeve, kohëzgjatjes dhe intensitetin e dhimbjes, frikës eventuale të përjetuar të paditësit gjykata ka caktuar ekspertët mjekësor Dr. A.T, Dr. M.H, dhe Dr. G.SH të cilët në mendimin e tyre kanë konstatuar se i aksidentuari ka përjetuar këto lëndime si pasojë e aksidentit: Frakturë e pjesës distal intraarticulare të radiusit me ndërprerje të procesit stiloid të ulnes dhe rupturë të TFCC të majtë, thyerje të kockës së ulnes së djathtë multifragmentare, plagë shqyese në regjionin e ballit majtas, hundës dhe mjekres, OP: Osteosinteze me tela të Kirschnerit të ulnes së djathtë, OP:Heqje e telave të Kirschnerit, OP: Osteosinteze të radiusit të majtë me pllakë, OP: Artodeze e nyjes së shuplakës së majtë. 1. Natyra e lëndimit, lëndimet e pësura karakterizohen si lëndime të rënda trupore, dhe me pasoja. 2. Dhimbja fizike, i aksidentuari ka përjetuar dhembje fizike të intensitetit posaqërisht të lartë: të cilat kanë zgjatur për rreth 30 minuta, deri në fillimin e ofrimit të ndihmës mjekësore.-Dhembje fizike të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 8 ditësh – kohë pas kohe, sidomos në ndërrimin e kushteve klimatike, qëndrimin të gjatë në këmbë dhe sforcimeve fizike me dorën e majtë, sipas të dhënave anamnestike të paditësit. 3.Frika- i aksidentuari ka përjetuar frikë primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej disa sekondave, kjo periudhë është e përcjellur me një shtangim afektiv. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka pasur në periudhën kohore prej katër ore të përcjellur me frymëmarje të vështirësuar, të rrahura të shpejtuara të zemrës, deridhje të muskujve, djersitje, mundim, ankesa tjera somatike. Frikë sekondare me intensitet të mesën ka pasur në periudhën kohore prej katër muajve të përcjellur me një qrrregullim të stabilitetit psikofizik si pasojë e aksidentit, si indisponim, pagjumësi, kufizim në aktivitetet e përditshme jetësore, prag më të ulët të tolerancës frustative, frikë nga invaliditeti i mundshëm, vështirësi në përqendrimin e vëmendjes si dhe ankesa tjera somatike. Frikë sekondare me instensitet të ulët ka pasur në periudhën kohore gjer në një vit e që është manifestuar gjatë kohëzgjatjes kur ka udhëtuar, apo ngjarjes që ja përkujtojnë aksidentin. 4.Shëmtimi trupor-ekziston në shkallë të mesme për shkak të vrrajave në regjionin e ballit majtas me gjatësinë 4 cm, mjekrës me gjatësi 3 cm, anës së majtë të hundës me gjatësi 3 cm, bërrylit të djathtë me gjatësi 11 cm, kristet illakale të majtë me gjatësi 5 cm, krahut të majtë me gjatësi 4 cm, regjioni volar radiokarpal i majtë me gjatësi 7 cm, dhe dorasi 8 cm. Këtu duhet pasur parasysh edhe moshën e paditësit. 5. Ndihma dhe përkujdesi i huaj ka qenë e nevojshme për 6 javë, për të kryer disa aktivitete të përditshme jetësore, i ndihmuar nga familjarët, për shkak të mbajtjes së imobilizimit të detyruar. 6.Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në periudhën kohore prej 35 ditësh, i pasur me proteina, minerale, vitamina B kompleks, ushqim më i përforcuar se i zakonshmi. 7. Mjekimi në të ardhmen- po 2 herë nga 21 ditë viti i parë, dhe 2 herë nga 21 ditë viti i dytë pas lëndimit, me qëllim të rikthimit të forcës muskulare dhe rritjes së amplitudes së lëvizjeve në bërrylin e djathtë dhe nyjen e shuplakës së majtë. 8. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor: 21% sipas tabelës për përcaktimin e zvogëlimit të përgjithshëm jetësor, të aprovuar nga MSH, me datë 03.10.2016 me numër 118/16, nyjen e bërrylit të djathtë në shkallë të mesme, bllokimit në nyjen radiokarpale të majtë në të njejtin rrafsh me parakrahun, hipotrofisë së parakrahut të majtë.



Nga ekspertiza mjekësore e datës 26.09.2019 e punuar nga grupi i ekspertëve XH.S ortoped – traumatolog, Dr. N.H ekspert i kirurgjisë maksillofaqciale, Dr. K.Z ekspert i neurologjisë, dhe Dr.sci N.M eksperte e psikiatrisë gjykata ka konstatuar se paditësi R. A. në aksidentin e komunikacionit të datës 03.08.2012, ka pësuar këto lëndime trupore Thyerje me shumë fragmente e olekranit të djathtë, thyerje brenda-nyjore me shumë fragmente e pjesës së poshtme të rrezorit të dorës së majtë, ndryshje e fytyrës, rrënjës së hundës dhe ballit, e shoqëruar me gërvishje dhe plagë prerëse të shumëfishta në anën e djathtë të fytyrës, hundës dhe përgjatë tërë dorës së djathtë, çrregullim i stresit posttraumatik kronik, çrregullim i dhimbjeve kronike me faktor psiqik dhe somatik si dhe çrregullim depresiv rekurent epizodë e shkallës së mesme deri te e rënda (diagnoza të kontatuara aktualisht sipas raportit mjekësorë dalës të Rehaklinik Hasliberg në Emmenbrucke ku ka qenë në rehabilitim nga data 14.02.2019 deri me datë 06.03.2019), ky lëndim trupor klasifikohet si lëndim i Rëndë trupor.

Ndërsa nga ekspertiza mjekësore e punuar nga grupi i ekspertëve Dr.V.B ortopede-traumatologe, Dr. S.R kirurg maksillofacial, Dr. SH.H psikitër, gjykata ka konstatuar se paditësi R. A. në aksident trafiku të datës 03.08.2012 ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të regjionit të fytyrës, rrënjës së hundës dhe ballit, plagë shqyrëse në regjioni e majtë të ballit, hundës dhe mjekrës, thyerje shumë fragmenëshe e olekranit të djathtë, thyerje brenda nyjore shumëfragmentëshe e byzykykut të dorës së majtë Op.Osteosinteya e olekranit të djathtë me tela të Krishnerit, Op. heqja e telave të Krishnerit në olekranin e djathtë Op.Osteosinteza e radiusit të majtë me pllakë, Op. Artrodeza e nyjes së byzykykur të dorës së majtë. Lëndimet: kategorizohen si lëndime të rënda trupore me pasojë të përjetshme. 1. Dhimbje fizike: Me intensitet posaçërisht të rëndë – 40 minuta duke marrë parasysh vendndodhjen e aksidentit, transpotin e deri në realizimin e ekzaminimeve klinike, radiologjike dhe marrjen e analgjetikëve në Spitalin Amerikan. Me intensitet të rëndë 7 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjes duke përfshirë edhe dhimbjet pas 4 intervenimeve kirurgjikale. Me intensitet të mesëm 40 ditë, kohë që është e nevojshme për tërheqjen e edemës dhe hematomës nga pjesët e thyera të bërrylit të djathtë dhe nyjes së byzykykut të dorës së majtë, dhe konsolidimit primarë kockorë. Me intensitet të ulët që posedon akoma në lëvizhe të bërrylit të djathtë dhe dorës së majtë, sidomos në sforcime fizike dhe ndërrime klimatike. 2.Frika – Frikë primare sipas të gjitha gjetjeve nga ekzaminimi direkt psikiatrik analiza e domumentacioneve në shkresat e lëndës, analiza e rrethanave të aksidentit si dhe gjetjet e ortopedit konstatojmë se i njejtë ka qenë duke vozitur motoçikletën e vet dhe është goditur direkt me veturën që ja ka prerë rrugën, andaj kështu edhe ka arritur shkurtazi ta shofë momentin e gpditjes andaj në këtë mënyrë ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej 1-2 sekonda. Frikë sekondare të intensitetit të lartë, nga momenti pas përfundimit të aksidentit kur ka kuptuar se çfarë ka ndodhur me të, i ka ndjerë lëndimet, vuajtjet nga dhimbjet e lëndimit në mënyrë rapide kanë filluar ankthi, habija, frika, dhimbje fizike dhe vuajtje shpirtërore deri në përfundimin e trajtimit dhe sigurimit që ka shpëtuar nga më e keqja, të gjitha këto gjetje dhe kjo gjendje psiko-fizike qojnë në konstatimin se paditësi në fjalë kishte përjetuar frikën sekondare të intensitetit të larë e cila ka zgjatur 3 ditë. Frikë sekondare e intensitetit të mesëm, është gjendja prej daljes nga klinika dhe vazhdimi i trajtimit shëndetësore në shtëpi. Në të jejtën kohë kanë vazhduar peripecitë si ndrojtja, frika, ankthi, pagjumësia herë pas here, kokëdhembje, frikë për invaliditet të mundshëm, frustracion për gjendjen aktuale në të cilën gjendet si pasojë e traumës së përjetuar. Të gjitha këto gjetje dërgojnë në konstatimin se

paditësi në fjalë e kishte përjetuar frikën sekondare të intensitetit mesatar e cila ka zgjatur gjashtë muaj. Frikë sekondare të intensitetit më të ulët, janë shqetësime e kohë pas kohshme, me simptomatologji të lartcekur por me intensitet më të ulur, ku më promitente është frika, pa gjumësia, rikujtimet për ngjarjen traumatike si dhe vështirësi në adaptim në aktivitete të përgjithshme mjekësore. Sipas të dhënave autoanamnestike dhe gjetjeve nga ekzaminimi i drejtë përdrejtë psikiatrik; frikë, ankth, pa gjumësi, vullnet i ulur i intensitetit të lehtë d.m.th paditësi ka manifestuar frikë të intensitetit të ulët edhe për një periudhë prej 18 muajve tjerë vijues.

3.Shëmtim trupor –ka të shkallës së mesme për shkak të: vrazës në regjionin e majtë ballor me gjatësi 4 cm, anës së majtë të hundës me gjatësi 3 cm, mjekrës me gjatësi 3cm, bërrylit të djathtë me gjatësi 11cm, kristës iake me gjatësi 5cm, krahut të majtë me gjatësi 4 cm, pjesës volare radio-karpale me gjatësi 7 cm dhe dorzale me gjatësi 8 cm, këto vrazja janë në pjesët e dukshme e që vërehen. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor është në shkallë prej 27% për shkak të zvogëlimit të lëvizjs së nyjes së bërrylit të shkallës së mesme-kapitulli III, pika 1.3.2 nën b), bllokimit të lëvizjes së nyjes së byzylykut të dorës së majtë në të njejtin rrafsh me parakrahun, kapitulli III pika 1.4.1, nën b), zvogëlimit të lëvizshmërisë së gishtërinjëve të dorës së majtë, kapitulli III, pika 1.5.10 nën a, pika 1.5.11. nën a dhe 1.5.12 nën a, e të përlogaritura me formulën e Balltazarit japin përqindjen e lartëcekur. Ndihma e personit të tretë – ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 6 javësh, ndihma e ofruar për kontrolla mjekësore dhe atë ndihmë në veshmbathje, mbajtje të higjienës personale dhe kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore. Ushqim i përforcuar – 80 ditë, i pasur me proteina, minerale, vitamin për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme pas thyerjes dhe për rritje të imunitetit. Rehabilitim fiziko-terapeutik – ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh në vitin e parë pas aksidentit dhe 2 x 20 ditë në vitin e dytë pas aksidentit për forcim të muskujve të dorës së majtë dhe zvogëlimin e kontrakturës së bërrylit të djathtë.

Lidhur me llojin, shkallën e pasojave, natyrën e lëndimeve kohëzgjatjen e intensitetit të dhimbjes, frikës eventuale të përjetuar nga paditësi gjykata në bazë të ekspertizës mjekësore të punuar nga grupi i ekspertëve Dr.V.B ortopede-traumatologe, Dr. S.R kirurg maksillofacial, Dr. SH.H psikitër, gjykata ka vërtetuar se paditësi si pasojë e aksidentit të trafikut të datës 03.08.2012 ka pësuar ndrydhje të regjionit të fytyrës, rrënjës së hundës dhe ballit, plagë shqyrëse në regjioni e majtë të ballit, hundës dhe mjekrës, thyerje shumë fragmenëshe e olekranit të djathtë, thyerje brenda nyjore shumëfragmentëshe e byzykykut të dorës së majtë Op.Osteosinteya e olekranit të djathtë me tela të Krishnerit, Op. heqja e telave të Krishnerit në olekranin e djathtë Op.Osteosinteza e radiusit të majtë me pllakë, Op. Artrodeza e nyjes së byzykykur të dorës së majtë, të cilat lëndime kategorizohen si lëndime të rënda trupore me pasojë të përjetshme. Dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë 40 minuta, me intensitet të rëndë 7 ditë, me intensitet të mesëm 40 ditë, me intensitet të ulët që posedon akoma në lëvizje të bërrylit të djathtë dhe dorës së majtë, sidomos në sforcime dhe ndërrime klimatike, Frikë primare sipas të gjitha gjetjeve nga ekzaminimi direkt psikiatrik analiza e domumentacioneve në shkresat e lëndës, analiza e rrethanave të aksidentit si dhe gjetjet e ortopedit konstatojmë se i njejt ka qenë duke vozitur motoçikletën e vet dhe është goditur direkt me veturën që ja ka prerë rrugën, andaj kështu edhe ka arritur shkurtazi ta shofë momentin e gpditjes andaj në këtë mënyrë ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej 1-2 sekonda. Frikë sekondare të intensitetit të lartë, nga momenti pas përfundimit të aksidentit kur ka kuptuar se çfarë ka ndodhur me të, i ka ndjerë lëndimet, vuajtjet

nga dhimbjet e lëndimit në mënyrë rapide kanë filluar ankthi, habija, frika, dhimbje fizike dhe vuajtje shpirtërore deri në përfundimin e trajtimit dhe sigurimit që ka shpëtuar nga më e keqja, të gjitha këto gjetje dhe kjo gjendje psiko-fizike qojnë në konstatimin se paditësi në fjalë kishte përjetuar frikën sekondare të intensitetit të larë e cila ka zgjatur 3 ditë. Frikë sekondare e intensitetit të mesëm, është gjendja prej daljes nga klinika dhe vazhdimi i trajtimit shëndetësore në shtëpi. Në të jejtën kohë kanë vazhduar peripecitë si ndrojtja, frika, ankthi, pagjumësia herë pas here, kokëdhembje, frikë për invaliditet të mundshëm, frustracion për gjendjen aktuale në të cilën gjendet si pasojë e traumës së përjetuar. Të gjitha këto gjetje dërgojnë në konstatimin se paditësi në fjalë e kishte përjetuar frikën sekondare të intensitetit mesatar e cila ka zgjatur gjashtë muaj. Frikë sekondare të intensitetit më të ulët, janë shqetësime e kohë pas kohshme, me simptomatologji të lartcekur por me intensitet më të ulur, ku më promitente është frika, pagjumësia, rikujtimet për ngjarjen traumatike si dhe vështirësi në adaptim në aktivitete të përgjithshme mjekësore. Sipas të dhënave autoanamnestike dhe gjetjeve nga ekzaminimi i drejtë përdrejtë psikiatrik; frikë, ankth, pa gjumësi, vullnet i ulur i intensitetit të lehtë d.m.th paditësi ka manifestuar frikë të intensitetit të ulët edhe për një periudhë prej 18 muajve tjerë vijues.

3.Shëmtim trupor –ka të shkallës së mesme për shkak të: vrazës në regjionin e majtë ballor me gjatësi 4 cm, anës së majtë të hundës me gjatësi 3 cm, mjekrës me gjatësi 3cm, bërrylit të djathtë me gjatësi 11cm, kristës iake me gjatësi 5cm, krahut të majtë me gjatësi 4 cm, pjesës volare radio-karpale me gjatësi 7 cm dhe dorzale me gjatësi 8 cm, këto vrazja janë në pjesët e dukshme e që vërehen. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor është në shkallë prej 27% për shkak të zvogëlimit të lëvizjs së nyjes së bërrylit të shkallës së mesme-kapitulli III, pika 1.3.2 nën b), bllokimit të lëvizjes së nyjes së byzylykut të dorës së majtë në të njëjtin rrafsh me parakrahun, kapitulli III pika 1.4.1, nën b), zvogëlimit të lëvizshmërisë së gishtërinjëve të dorës së majtë, kapitulli III, pika 1.5.10 nën a, pika 1.5.11. nën a dhe 1.5.12 nën a, e të përlllogaritura me formulën e Balltazarit japin përqindjen e lartëcekur. Ndihma e personit të tretë – ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 6 javësh, ndihma e ofruar për kontrolla mjekësore dhe atë ndihmë në veshmbathje, mbajtje të higjienës personale dhe kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore. Ushqim i përforcuar – 80 ditë, i pasur me proteina, minerale, vitamin për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme pas thyerjes dhe për rritje të imunitetit. Rehabilitim fiziko-terapeutik – ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 30 ditësh në vitin e parë pas aksidentit dhe 2 x 20 ditë në vitin e dytë pas aksidentit për forcim të muskujve të dorës së majtë dhe zvogëlimin e kontrakturës së bërrylit të djathtë.

Gjykata në tërësi i ka pranuar konstatimet të eksperteve me fjalë të njëjtit janë dhënë nga ana e ekspertëve përkatës, të cilat përputhen në mes veti si dhe me provat tjera e posaçërisht me dokumentacionin mjekësor që ju është bashkangjitur shkresave të lëndës.

Për lartësinë e kërkesë padisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e dëmit jo material gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si dhe Udhëzuesin për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material GJ.A-Su.A 41/2023, datës 27.02.2023, me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur

parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksionin, për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit jo material, Gjykata e mori parasysh natyrën e lëndimeve trupore të cilat i kishte pësuar paditësi, në aksidentin e ndodhur, mënyrën e manifestimit, intensitetit dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar, sipas gjetjeve të bëra nga ekspertët mjekësor, moshën e paditësit, në kohën e incidentit, por edhe praktikën e gjertanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi në shumën e gjykuar për këtë lloji dëmi të jetë satisfaksion për paditësin, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e kompensimit në raste të tilla, praktikën e mirë gjyqësore, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar I, si dhe duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 200 të LMD-së përcaktohet se *“me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi, i ka pësuar në këtë incident.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit jo material, nuk është shpërblim i plotë, por është satisfaksion, për të dëmtuarin, çka në rastin konkret shumat e gjykuara janë të drejta për të.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të zvogëlimit të aftësisë punuese ka nxjerrë ekspertizën e ekspertit të punës të punuar nga Dr.XH.SH të datës 07.01.2023 sipas të cilës ka konstatuar se Zvogëlimi i aftësisë së përgjithshme – i përhershëm i punës 35 % (tridhjetë e pesë përqind). Pa aftësia e përkohshme për punë – për vitin e parë nga data e lëshimit (03.08.2012 deri 02.08.2013), i lënduari nuk ka qenë i aftë 100% për kurfarë pune fizike e as psiqike për shkak të lëndimeve të pësuar, hospitalizimit, disa intervenime operative, imobilizimit, kontrollave të shpeshta dhe ekzaminimeve përcjellëse), për vitin e dytë ( prej datës 03.08.2013 deri 02.08.2014), pa aftësia për punë ka qenë 60% (për shkak të rikuperimit, trajtimeve në kontinuitet, ndërhyrjeve operative, kontrollave mjekësore dhe rehabilitimeve), Ndërkaq që nga data 03.02.2014 e më tutje Zvogëlimin e aftësisë të përgjithshme të përhershme të punës është 35%. Rekomandohet të vizitohet herë pas here te ortopedi, kirurgu plastik, psikiatri, psikologu, dhe fiziatri.

Sa i përket dëmit material rentes së arritur dhe për të ardhmen është nxjerrë ekspertizë financiare e punuar nga eksperti M.M nga Peja i cili në bazë të ekspertizës së punuar me datë 31.01.2024, sqarimeve të dhëna në seancën e datës 05.03.2024, ka konstatuar se fitimi i humbur, renta mujore dhe renta e kapitalizuar për paditësin R. (A...) A. sipas VERSIONIT 1 është: Fitimi i humbur për periudhën 03.08.2012-31.01.2024 256,840.07 euro, kamatvonesat mbi fitimin e humbur për periudhën 03.08.2012-31.01.2024 është 131.108.84 euro, gjithësejtë Fitimi i humbur (përfshirë kamatën) 387,948.91 euro, Renta e kapitalizuar për periudhën prej 01.02.2024 deri më 21.10.2034 është 188,824.51 euro. Renta mujore vijuese në rast të mospagesës së rentës së

kapitalizuar është në shumën 1,819.64 euro, e gjithsejtë për Fitim të humbur, rentë të kapitalizuar dhe kamatëvonesat shumën prej 576,773.42 euro. Fitimi i humbur, renta mujore dhe renta e kapitalizuar për paditësin R. (A...) A. sipas VERSIONIT 2 janë si vijon: Fitimi i humbur për periudhën 03.08.2012-31.01.2024 shuma prej 104,296.75 euro, kamatëvonesat mbi fitimin e humbur për periudhën 03.08.2012-31.01.2024 21,309.17 euro gjithsejtë fitimi i humbur (përfshirë kamatën) 125,605.92 euro, Renta e kapitalizuar për periudhën 01.02.2024 deri më 21.10.2034 është 98,230.93 euro, renta mujore vijuese në rast të mos pagesës së rentës së kapitalizuar është në shumën 946.62 euro, e në shumë të përgjithshme për Fitimin e humbur, rentën e kapitalizuar dhe kamatëvonesën 223,836.85 euro. Duke shtuar se fakti se sa është paguar paditësi është i ditur në shkresat e lëndës nga një deklaratë në faqën 175 që i referohet shumës të cilën e pranon paditësi nga kompania “Suva”.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, si në pikën III, në dispozitivi të këtij aktgjykimi, që ndërlidhet me demin jo material, gjykata vendosi, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejtë.

Po ashtu, edhe sa i përket kërkesëpadisë që ka të bëjë me demin material, për ndihmë dhe kujdes të huaj shumën prej 1,500.00 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 1,000.00 euro, shpenzime të mjekimit shumën prej 1,000.00 euro, në emër të Rentës së arritur për periudhën kohore prej 03.08.2012 deri më 31.01.2024 shumën prej 104,296.75 euro, si dhe kamatvonesës prej datës 03.08.2021 e deri me datë 31.01.2024 shumën prej 21,309.17 euro, apo në shumën e tërësishme prej 125,605.92 euro. Në emër rentës vijuese, për të ardhmen duke filluar nga data 01.02.2024 e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, përkatësisht deri me 21.10.2034, kur paditësi do të pensionohet, të njejtit t’i paguhet shuma mujore prej nga 946.62 euro dhe atë në fund të secilit muaj, e më së voni deri me datën pesë të muajit vijues, për secilin muaj paraprak, ose shumën e gjithëmbarshme të rentës për periudhën 01.02.2024 e deri me datë 21.10.2034, prej 98,230.93 euro.

Gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar pasi që nga shkresat e lëndës veçanerisht nga deklarata e paditësit e datës 16.10.2017, është vërtetuar se paditësi R. A., nga S. Luzern, mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm me numër 06.885205.12.2 e përkitazi me pasojat e lëndimeve trupore nga aksidenti i trafikut i datës 03.08.2012 në Kosovë, nga ky siguroes janë bartur dhe paguar mjetet – shuma prej 149,550.35 CHF në emër të kompensimit për kohën e paaftësisë për punë nga dita e aksidentit e deri më datës 31.11.2016. Shuma e gjithëmbarshme prej 327,344.25 CHF, si dhe nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.326/15 ,vërtohet së nga kompania S. L. Zvicërr është kërkuar rimbursimi i mjetëve mbi bazën e suborgimit për rastin e siguruar si shkak i aksidentit të datës 03.08.2021, shumën prej 220,885.52 euro, për shpenzimet e mjekimit dhe fitimin e humbur për periudhën kohore nga data e aksidentit e deri me datë 30.05.2017. Ndërsa me padinë e datës 18.06.2021, rimbursimi i rentes mujore për invaliditet prej datës 01.06.2017 deri me datë 31.12.2022 shumën prej 50,512.00 CHF, ndërsa prej datës 01.01.2023 e për të ardhmen shumën prej 816.10 CHF.

Nga këto vërtetohet së paditësi është kompensuar për dëmin material, që ka të bëjë me ndihmë dhe kujdes të huaj shumë prej, për ushqim të përforcuar, shpenzime të mjekimit, dhe renten e arritur dhe për të ardhmen, i njëjti nuk mund të kompensohet dy herë për të njëjtin rastë.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet e ngritura nga e paditura, ne bazë të deklaramit të përfaqësuesit të paditues se nuk e konsideronte veten tërësisht përgjegjëse dhe se kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë së paku 70% me 30% në favor të paditësit, pretendimet e ngritura nga përfaqësuesi i të paditues. Mirëpo, për gjykatën këto kundërshtimet ishin jo relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore, pasi që në kuptim të nenit 7 dhe 319 të LPK-së për vërtetimin e pretendimeve të tilla barra e provës i binte palës së paditur, mirëpo të paditurat me asnjë provë nuk i kanë argumentuar këto pretendime-kundërshtime, për çka gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me kamatën, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konform nenit 382 të LMD-së, dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme, lidhur me kamatën, ashtu që është vendosur për dëmin material kamata të llogaritet duke filluar nga data 25.03.2024 e deri në pagesën definitive, nga momenti kur gjykata ka vendosur me aktgjykim dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Gjykata nuk ka marr për bazë kamatën prej 12%, pasi që paditësi nuk ka prezantuar prova me të cilën kish me argumentuar së ka parashtruar kërkesë në procedure administrative të e paditura dhe që e njëjta ka ren në vonës që të aplikohet kjo kamatë.

Vendimin që pala e paditur ti bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e paditësit ne këtë procedurë.

Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë: për padi 325 euro, taksën për padi 100 euro, 17 seanca të mbajtura 7.182 euro, 4 seanca të shtyera 844 euro, kompensimin për ekspertët nga lëmia e ortopedisë 400 euro, kompensimin për ekspertin nga lëmia e psikiatrisë 350 euro, kompensimin për ekspertin nga lëmia e kirurgjisë maksillofaciale 150 euro, kompensimin për ekspertin e mjekësisë së punës 250 euro, kompensimin për ekspertin financiar – aktuarin 500 euro, kompensimin për përkthimin e dokumentacionit nga gjuha gjermane 50 euro, e gjithsejtë shumë prej 9,569.00 euro. Ndërsa për shumën prej 3,380.00 euro, në emër të shpenzimeve të mbylljes së zyrës për 17 seanca (7.182x25%) 1.795 euro, shpenzimet e udhëtimit me veturë për 17 seanca të mbajtur dhe 4 të shtyera 21 x 60 km= 1.260 x 30% për km të kaluar 325 euro, është refuzuar si e pa bazuar dhe pa mbështetur në dëshmi mbi shumë e shpenzimeve të krijuara.

Nga të lartë cekurat u vendos sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departament i përgjithshëm,**

**C.nr.38/13, me datë 25.03.2024**

**G J Y Q T A R I**  
Shemsedin Haxhiaj

**Udhëzim Juridik :**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.